

URDHËR
Nr. 197, datë 22.7.2022

**PËR SHPALLJEN E KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES DHE PROCESIT TË
APLIKIMIT PËR ADMINISTRATORËT E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES
VENDORE (NJVQV-ve QË MUND TË JENË NË KUSHTET E VËSHTIRËSIVE
SERIOZE FINANCIARE APO PAAFTËSISË PAGUESE)**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; në zbatim të pikës 5, të nenit 59, të ligjit nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”; dhe pikave 157 dhe 171, të udhëzimit nr. 26, datë 27.9.2019, “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, ministri i Financave dhe Ekonomisë

URDHËRON:

1. Shpalljen e kriterëve të përzgjedhjes dhe fillimin e procesit të aplikimit për administratorët e njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVQV-ve që mund të jenë në kushtet e vështirësive serioze financiare apo paaftësisë paguese).

2. Aplikanti për administrator i njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë arsimuar në shkencat ekonomike ose shkencat juridike (me Master shkencor);
- b) të ketë eksperiencë në punë të paktën 10 vjet në administratën publike;
- c) të ketë njohuri të thelluara dhe kualifikime në fushën e menaxhimit të financave publike në nivel vendor;
- d) nuk duhet të ketë konflikt interesi me njësitë e qeverisjes vendore.

3. Afati i aplikimit të kandidatëve për t’u përzgjedhur në listën e administratorëve të njësive të vetëqeverisjes vendore është 40 ditë pune nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

4. Aplikanti do të dorëzojë në protokollin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet rrugës postare apo dorazi, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesë me shkrim;
- b) fotokopje të kartës së identitetit;
- c) adresën e vendbanimit, vendit të punës dhe pikave të kontaktit;
- d) kopje të diplomës, listës së notave dhe një përmbledhje të edukimit, kualifikimeve dhe eksperiencës së punës;
- e) një fotografi të përmasave 4x6;
- f) kopje të licencave dhe/ose të certifikatave profesionale në fusha dhe profesione të rregulluara me ligj;
- g) dëshmi dhe certifikata të trajnimeve dhe të kualifikimeve pasuniversitare;
- h) vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.

5. Ky urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, shpërndahet nëpërmjet rrugëve elektronike zyrtare dhe botohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare (QBZ).

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj